



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
GJIROKASTËR

Nr. Akti 672 [11232-00682-21-2018]
Data e regjistrimit 21.09.2018

Nr. Vendimi 672
Data e vendimit 21.09.2018

V E N D I M

“Për sigurim e pjesës së shtuar në objektin e kundërpadisë”

Gykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e përbërë nga:

Gjyqtar : ARBEN DOSTI

asistuar prej sekretares gjyqësore **Znj. Ervehe Tosuni**, në Gjirokastrë, në datën 21.09.2018, përfundoi shqyrtimin pa prezencë të palëve, të çështjen civile me:

Kërkues:

Albert Kaçi, i biri i Kristos, i datëlindjes 10.03.1967, në cilësinë e aksionerit dhe administratorit të shoqërisë “ Petrol Gaz: sh.a dhe “ Andkri” shpk.

Objekti i padisë:

Shtim i objektit të kundërpadisë me:

1. Prishjen e shoqërie “ Petrol Gaz” sh.a dhe “ Andkri” sh.p.k. Likujdimi e tyre. Caktimin e një eksperti likujdator. Regjistrimin e vendimit në QKR.

2. Sigurimin e kundërpadisë për pjesën e shtuar të objektit në këtë kërkesë me bllokimin e çdo aseti, kapitali të shoqërisë, si dhe të drejtën e administratorit Adrian Çela të kryejë veprime në cilësinë e administratorit në shoqërinë “ Petrol Gaz” sh.a.

B. Ligjore:

Neni 185 i K.Pr.Civile

Gjykata, pasi, shqyrtoi provat e paraqitura pa praninë e palëve,

VËREN:

Se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është paraqitur kërkesë - padia me paditës Shoqëritë “ Petrol Gaz” sh.a dhe “ Andkri” sh.p.k kundër të paditurit Albert Kaçi me objekt “ *Përfshirja e të paditurit nga pjesëmarrja si aksionet në shoqërinë “ Petrol Gaz” sh.a. Mos likuidimi i kuotës së aksionerit Albert Kaçi nga ana e shoqërisë për shkak të përfshirjes së tij për shkak të arsyeshme. Shkaktimi i të paditurit nga detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit dhe të administratorit të shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërië “ Petrol Gaz” sh.a nga veprimet që kanë sjellë përfshirjen e të paditurit. Detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, përfshirë edhe ato të përfaqësimit. Përfshirja e të paditurit nga pjesëmarrja si ortak në shoqërinë “ Andkri” sh.p.k. Mos likuidimi i kuotës së ortakut Albert Kaçi nga ana e shoqërisë, për shkak të përfshirjes së tij për shkak të arsyeshme. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë “ Andkri” sh.p.k nga veprimet që kanë sjellë përfshirjen e të paditurit. Detyrimin e të paditurit përfshirë edhe ato të përfaqësimit.*

Me vendimin e datës 06.09.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkimin për sigurimin e padisë ka vendosur: *Pranimin pjesërisht të kërkesës. Përfshirjen e ushtrimit të të drejtave e kompetencave, të anëtarit të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, të paditurit Albert Kaçi, deri në përfundim të gjykimit të çështjes së themelit. Përfshirjen e të drejtave të ushtrimit të kompetencave të administratorit, për të paditurin Albert Kaçi, si dhe përfshirjen e zbatimit të vendimit të asamblesë së aksionarëve të shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, duke u kryer administrimi i shoqërisë vetëm nga administratori Adrian Çela, deri në përfundim të gjykimit të çështjes. Përfshirja e ushtrimit të të drejtave e kompetencave të administratorit të shoqërisë “Andkri” sh.p.k, të paditurin Albert Kaçi, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Përfshirjen e zbatimit të vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “Andkri” shpk, datë 23.10.2017, duke u kryer administrimi i shoqërisë, vetëm nga administratori Adrian Çela, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve”.*

Z. Albert Kaçi si dhe shoqëritë “Petrol Gaz” sh.a dhe “Andkri” sh.p.k kanë paraqitur një

kundërpadi në të cilën kërkojnë "Përjashtimi i të paditurit Adrian Çela nga pjesëmarrja si aksioner në shoqërinë "Petrol Gaz" sh.a. Mos likujdimi i kuotës së aksionerit Adrian Çela nga ana e shoqërisë " Petrol Gaz" sh.a, për shkak të përjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme. Shkarkimin e të paditurit Adrian Çela nga detyra e anëtarit të Këshilit të Administrimit dhe të administratorit të shoqërisë "Petrol Gaz" sh.a. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë " Petrol Gaz" sh.a, nga veprimet që kanë sjellë si pasojë përjashtimin e të paditurit. Detyrimin e të paditurit Adrian Çela për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, përfshirë edhe ato të përfaqësimit. Përjashtimi i të paditurit Adrian Çela nga pjesëmarrja si ortak në shoqërinë " Andkri" sh.p.k. Mos likujdimi i kuotës së ortakut Adrian Çela nga ana e shoqërisë, për shkak të përjashtimit të tij për shkaqe të arsyeshme. Shpërblimin e dëmit të shkaktuar shoqërisë " Andkri" sh.p.k nga veprimet që kanë sjellë përjashtimin e të paditurit. Detyrimin e të paditurit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore, përfshirë edhe ato të përfaqësimit.

Me vendim të ndërmjetëm, gjykata vendosi pranimin për shqyrtim të kundërpadisë, pasi çmoi se mes kërtimeve të padisë dhe kundërpadisë ka lidhje. Kundërpadia shoqërohej edhe me kërkesë për sigurim të saj, ku në përfundim të gjykimit të kërkesës për sigurim kundërpadie, gjykata ka vendosur që shoqëria " Petrol Gaz" sh.a të administrohej nga administratori Adrian Çela dhe shoqëria " Andkri" sh.p.k nga administratori Albert Kaçi.

Rezulton se Albert Kaçi në cilësinë e kundërpaditësit ka paraqitur një kërkesë për shtimin e objektit të kundërpadisë duke kërkuar " 1. Prishjen e shoqërive " Petrol Gaz" sh.a dhe " Andkri" sh.p.k. Likujdimin e tyre. Caktimin e një eksperti likujdator. Rregjistrimin e vendimit në QKR. 2. Sigurimin e kundërpadisë për pjesën e shtuar të objektit në këtë kërkesë me bllokimin e çdo asetit, kapitali të shoqërisë, si dhe të drejtën e administratorit Adrian Çela të kryejë veprime në cilësinë e administratorit në shoqërinë " Petrol Gaz" sh.a."

Gjykata konstaton se në nenin 185 të K.Pr.Civile parashikohet se " 1. Paditësi gjatë veprimeve përgatitore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për ndryshimin e shkakut të padisë. Ai pa e ndryshuar shkakun e padisë, mund të shtojë, të pakësojë ose të ndryshojë objektin e saj.

2. Në seancë gjyqësore mund të shtohet, pakësohet ose ndryshohet vetëm objekti i padisë, kur një nevojë e tillë lind për shkak të provave të marra në seancën gjyqësore.

3. Kur ndryshimet e mësipërme bëhen në mungesë të të paditurit ose të personave të tretë të thirrur në gjykim, duhet t'u komunikohen atyre me shkrim.

4. Nuk quhet shtesë e objektit të padisë, kërkitimi i kamatës ose i të ardhurave të tjera të

objektit.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata vlerëson se legjislatori i ka njohur të drejtën paditësit të dispozojë lirisht objektin e padisë, të kushtëzuar vetëm nga rregullime procedurale ligjore. Konkretisht duhet që kërkesa të paraqitet në fazën e veprimeve përgatitore të çështjes (dhe/ose gjykim) dhe ndryshimi i objekti të padisë, nuk duhet të shoqërohet me ndryshim edhe të shkakut të padisë. Nuk rezulton që të ketë një mundësi të gjykatës që të shprehet lidhur me koneksitetin e kërkimeve, apo themelin e pretendimeve, por vetëm të shqyrtojë plotësimin e kushteve procedurale.

Në rastin në shqyrtim, rezulton se padia e Z. Adrian Çela së bashku me kundërpadinë e Z. Albert Kaçi, është në fazën e veprimeve përgatitore (*në pritje të sjelljes së deklaratës së mbrojtjes*). Është kërkuar ndryshimi i objektit të padisë, pa u kërkuar ndryshimi i shkakut ligjor të saj, që është mosfunksionimi dhe dëmtimi i interesave të shoqërisë për shkak të veprimeve të pretendura reciprocisht me faj, të aksionerëve, ortakëve dhe aksionarëve të shoqërive.

Në këto kushte, gjykata vendosi pranimin e kërkesës për shtimin e objektit të kundërpadisë. Në kushtet e pranimit të kërkesës, gjykata procedoi me njoftimin e palëve ndërgjyqëse.

Konstatohet se në objektin e shtuar të kundërpadisë, është kërkuar edhe sigurimi i kundërpadisë, për bllokimin e pasurive të shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a dhe të drejtës së administrimit të administratorit Adrian Çela.

Në kërkesën për sigurimin e objektit të shtuar të kundërpadisë, kërkuesi Albert Kaçi pretendon se “ *...Ditët e fundit, nga ana e palës tjetër, përveç abuzimeve dhe vjedhjeve të kryera më parë, e të denoncuara në Prokurori, për të cilën ka filluar procedim penal, në ngarkim të tij (administratorit Adrian Çela), për veprën penale “ Vjedhja” parashikuar nga neni 134 i K.Penal, janë kryer edhe veprime aktive nëpërmjet abuzimeve me një përmbaues privat duke nisur shtesa DRSHTRR Gjirokastër, me qëllim tjetërsimin e të gjitha mjeteve të shoqërisë, siç janë autobote, bote, kamiona të ndryshëm, si dhe duke i drejtuar AVRPP Gjirokastër, shkresë për tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërive, si dhe çdo dege banke, ku ne kemi llogaritë tona për të vijuar vjedhjen në prona të përbashkët, asete të shoqërive. Prandaj kjo e bën të domosdoshme marrjen e masës urgjente të sigurimit të objektit të shtuar të kësaj kundërpadie, duke bllokuar çdo aset, kapital të shoqërisë, si dhe të drejtën e administratorit Adrian Çela të kryejë*

veprime në cilësnë e administratorit në shoqërinë “ Petrol Gaz” sh.a. Prandaj kërkoj bazuar në nenin 205 të K.Pr.Civile që kërkesa të shqyrtohet në dhomë këshillimi, me qëllim që një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet të gjitha degëve të bankave, ku ne kemi llogaritë tona , si dhe pranë DRTRR Gjirokastër, ku kemi mjete të rregjistruara, si dhe ZVRPP Gjirokastër, ku janë të rregjistruara pasuri të paluajtshme”.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata, duke qënë se ka dhënë në të njejtin gjykim, vendime të tjera për sigurimin e padisë/kundërpadisë, e çmon të panevojshme, analizimin e fakteve dhe pretendimeve të palëve në padi e kundërpadi, lidhur me sjelljen e secilit ortak/aksionar dhe administrator të shoqërive “Petrol Gaz” sh.a dhe “ Andkri” sh.p.k. Do të përqëndrohet vetëm tek kërkimi i palës në kërkesën për sigurimin e objektit shtesë të kundërpadisë.

Gjykata duke njohur konfliktin mes palëve, pretendimet për abuzivitet për administrimin e pasurisë së shoqërisë, kohëzgjatjen e administratorit në detyrë në shoqërinë “ Petrol Gaz” sh.a, çmon që ta shqyrtojë kërkesën pa praninë e palëve, sipas nenit 205/2 të K.Pr.Civile, për të shmangur çdo evetualitet shpërdorimi të kompetencave të administrimit ndaj shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a. Në këtë vendimarrje ndikoi dhe fakti se dy ditët në vazhdim ishin ditë pushimi (fundjavë) dhe gjykata nuk mund të zhvillonte gjykim.

Rezulton se në dy gjykimet e mëparshme për sigurimin e padisë/kundërpadisë, gjykata ka patur si qëllim në vendimarrjen e saj, vijimin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërive, për sa kohë prezumohet se në këto shoqëri, nuk janë të lidhura vetëm interesat e ortakëve njëkohësisht edhe administratorë, por edhe të palëve të treta, punonjës, kreditor apo debitor. Për këto arsye, ka vendosur që administrimin e shoqërisë “ Petrol Gaz” ta kryej administratori Adrian Çela dhe administrimin e shoqërisë “ Andkri” sh.p.k, ta kryej administratori Albert Kaçi, duke ruajtur secili të drejtën në cilësinë e ortakut/aksionerit, të kundërshtojë në gjykatë çdo veprim të administratorit në dëm të interesave të shoqërive.

Për shoqërinë “ Petrol Gaz” sh.a ka pezulluar dhe të drejtën e Z. Albert Kaçi si anëtar i Këshillit të Administrimit, me qëllim moscënimin e vendimarrjes së gjykatës nga një vendimarrje e mëpasme e këshillit. Këto vendime të gjykatës kanë fuqi juridike deri në kohëzgjatjen e caktuar nga Asambleja, në lidhje me administrimin e shoqërisë (këshill

administrimi dhe administrator). Tej datës së përfundimit të kohëzgjatjes së caktuar me vendim të asamblesë për anëtarët e këshillit të administrimit dhe këta të fundit për administratorin, vendimarrja e gjykatës nuk ka fuqi juridike, pasi:

- a) Ka patur për objekt një gjendje faktike administrimi të shoqërisë dhe nuk mund të shprehet për një të ardhme të pasigurtë, vendimarrje të Asamblesë së Ortakëve dhe/ose të Këshillit të Administrimit.
- b) Rastet se kur ndërhyjnë gjykata në një shoqëri tregtare janë parashikuar në mënyrë shteruese në ligjin nr. 9901/2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, duke mos patur asnjë mundësi të gjykatës që të marrë kompetencat e Asamblesë së Aksionerëve, apo Këshillit të Administrimit të shoqërisë, në caktimin e administratorëve të shoqërisë.

Referuar ekstraktit të shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, rezulton se administratorët e shoqërisë, si dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit, kanë të drejtën të ushtrojnë këto funksione, deri në datën 30.09.2018. Në kushtet kur gjykimi po zhvillohet në datën 21.09.2018, mbeten edhe 9 ditë që të vazhdojnë të funksionojnë organet e administrimit të shoqërisë.

Rezulton se administratori i shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, Adrian Çela, menjëherë sapo ka përfunduar gjykimi për sigurimin e padisë, ka kontraktuar një përmbarues gjyqësor, i cili ka dërguar shkresa njoftimi në bankat e nivelit të dytë, ZVRPP dhe DRSHTRR Gjirokastër. Njëkohësisht përmbaruesi gjyqësor ka kryer dhe inventarizimin e pasurisë së shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, veprime këto që vlerësohen nga gjykata në tejkalim të urdhërimeve të saj, si dhe proçedurës së parashikuar në ligj (për QKR, QKB) për ekzekutimin e vendimit të gjykatës.

Gjykata vlerëson se në kushtet kur është paraqitur për gjykim një kundërpadi me objekt prishjen e shoqërisë, ka një vendim të gjykatës që administrimin e shoqërisë ja ka lënë vetëm administratorit Adrian Çela, ndaj këtij administratori Prokuroria mbi bazën e kallzimit të kërkuesit Albert Kaçi ka filluar proçedim penal për veprën penale “ Vjedhja”, kur veprimet e përmbaruesit konsiderohen në tejkalim të urdhërimeve të gjykatës, si dhe faktin që në datën 30.09.2018 përfundon afati i funksionimit të organeve të administrimit të shoqërisë, kërkesa për bllokim të pasurisë së shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a është e bazuar në prova dhe ligj. Por gjykata do të disponoj me bllokimin e pasurisë së shoqërisë “Petrol Gaz” sh.a, deri në datën 01.10.2018, duke i lënë të lira këto pasuri pas kësaj date, për

vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë, sipas disponimeve të Asamblesë së Aksionarëve.

Sa më sipër;

Gjykata, bazuar në nenet 202-210 të K.Pr.Civile

V E N D O S I:

1. Sigurimin e padisë për pjesën e shtuar në objektin e kundërpadisë me palë: Shoqëria “Petrol Gaz” sh.a, shoqëria “ Andkri” sh.p.k, Albert Kaçi, kundër Adrian Çela.
2. Bllokimin e pasurisë (pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme) të shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a dhe ndalimin e kryerjes së çdo veprimi administrimi mbi pasurinë e shoqërisë “ Petrol Gaz” sh.a, deri në datën 01.10.2018.
3. Kundër vendimit për sigurimin e kundërpadisë, lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, ankim i cili nuk pezullon ekzekutimin e masës së sigurimit të kundërpadisë.

U shpall në Gjirokastër, më 21.09.2018

SEKRETARE

ERVEHE TOSUNI

GJYQTAR

ARBEN DOSTI



Handwritten text in the top right corner, possibly a page number or date, which is mostly illegible due to fading.

